# DËSHMI ARKIVI

**A-401935**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gjermani/ Senati refuzoi të paguante shantazhin 2 milionë euro, hakerët publikojnë 1.4 milionë dosje sekrete, mes tyreplane për sulme bërthamore |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/gjermani-senati-refuzoi-te-paguante-shantazhin-2-milione-euro-hakeret-publi-i584292` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 12:56:45 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 6 shtator 2026, 13:15:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0705c31e3258d3bd77988a9d7bab1a9ee25e5bdf265a34e746651d7a3bab972f` |
| TEKSTI | `1274f4fd3d62617ca13e7d2001b9531d3c6fb5363087a0e11b64cf5731b14419` |
| PAMJA | `370471e5a230a86e5db7fae274f22e38fa7ffe1325e21bb00edb6e4798b70b5e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `062e985d5a428b504bb437dc1390406f3fb525886abbce4440011023d4aa33c4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `475d518598164a6fca4ccfef21e2861f646caa940cdcee184ece19d66f24a93c` |
| ANKORUAR | Polygon PoS · bllok 47086362 |
| TRANSAKSIONI | `0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2` |
| IPFS | `QmdKiUsbe1dzvDLxvAjpyRejoiJFNmdMrnWrgD5SJRvybp` |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/062e985d5a428b504bb437dc1390406f3fb525886abbce4440011023d4aa33c4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Gjermani/ Senati refuzoi të paguante shantazhin 2 milionë euro, hakerët publikojnë 1.4 milionë dosje sekrete, mes tyreplane për sulme bërthamore

TemA
6 Shtator 2026, 15:15Bota TEMA



Grupi i piratëve informatikë “Rhysida” ka publikuar thuajse 6 “terabyte” të dhëna nga administrata shtetërore e Berlinit në “dark web”.

Sipas informacioneve të mediave gjermane, shkalla e rrjedhjes së të dhënave është madhore, plot 1 milion e 440 mijë dosje, mes të cilave ka edhe të dhëna të rëndësishme.

Mes tyre spikat një material për kërcënimet me armë kimike, biologjike dhe bërthamore – bëjnë të ditur burimet mediatike.

Kjo do të thotë se informacione të rëndësishme mbi skenarët e kërcënimeve të mundshme janë tashmë të aksesueshme si nga publiku i thjeshtë, ashtu edhe nga terroristët apo shërbimet sekrete të huaja.

Gazetari investigativ Lars Uinkels Dorf ka dhënë alarmin në rrjetin “X”, duke deklaruar se sulmi kibernetik ka një “magnitudë që kërcënon të gjithë shtetin”.

“Dosjet përmbajnë gjithashtu plane që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare e që variojnë nga kanalet sekrete të komunikimit të zyrtarëve qeveritarë në rast të një apokalipsi, tek kompanitë e lidhura me fushën e mbrojtjes dhe tek planet e emergjencave të hartuara nga agjencitë qeveritare”, ka shkruar Uinkels Dorf.

Mes materialeve të publikuara ka gjithashtu të dhëna për zyrtarët shtetërorë, përfshirë certifikatat e lindjeve, numrat e telefonit dhe adresat e shtëpive të tyre.

Hakerat kërcënuan se do të publikonin të dhënat në website-n e tyre dhe kërkuan një shpërblim prej 30 Bitcoin, rreth 2 milionë euro, për të mos e bërë këtë. Ata vendosën edhe një afat.

Por Senati në Berlin e bëri të qartë përpara skadimit të ultimatumit se, për çështje parimore, nuk do të dorëzohej përpara këtij shantazhi.

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Dokumenti i BE-së: Rusia dërgoi fëmijë ukrainas të rrëmbyer në një kamp në Korenë e Veriut]

14:45 Bota

"Rrezik për një tjetër Irak ose Afganistan" - Ish-sekretari amerikan i Mbrojtjes: Trump e ka futur veten në një ngërç, SHBA duhet të ndryshojë strategji për ta fituar luftën

14:35 Bota

"Dekolonizim" apo censurë? Qyteti rusishtfolës i Odesës përgatit kufizime të reja ndaj gjuhës ruse në art dhe kulturë

13:35 Bota / 1 koment



Tragjedi në Kepin e Gjelbër, autobusi me studentë bie nga 30 metra! Të paktën 21 viktima

13:15 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.